



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PML.nr.395/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegj i përberë nga gjyqtarët Agim Maliqi, kryetar, Mejreme Memaj e Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve Iran Badalli, nga fshati ..., komuna e P., dhe Arben Gashi, nga ..., tani me vendbanim në P., rruga “ E. H.”, nr..., për veprat penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në bashkëkryerje, parashikuar me nenin 356 par.5 lidhur me par.4 e 1 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesat e mbrojtësve të dënuarve për mbrojtje të ligjshmërisë, avokatëve Hazër Susuri e Elinda Susuri - Humolli dhe Emira Gavazaj e Valdrin Gashi, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 61/2021 datë 19 shtator 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 23 dhjetor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve Iran Badalli e Arben Gashi për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 61/2021 datë 19 shtator 2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 61/2021 datë 19 shtator 2023, të pandehurit Iran Badalli e Arben Gashi janë shpall fajtor për shkak se si bashkëkryesor kanë kryer veprat penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në bashkëkryerje, parashikuar me nenin 356 par.5 lidhur me par. 4 e 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe pasi që u janë caktuar dënimet për secilën veprë

veç e veç dhe atë për veprën e parë – secilit nga njëmbëdhjetë (11) vite burgim, për veprën e dytë secilit nga dy (2) vite burgim, konform dispozitës së nenit 76 par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së janë gjykuar me dënime unike me burgim secili me nga dymbëdhjetë (12) vjet. Në dënimin e shqiptuar të pandehurit Iran i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej 28.01.2020 e tutje, kurse të pandehurit Arben i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 12.02.2020 e tutje. Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore sipas ankesës së prokurorit dhe mbrojtësve të pandehurve Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur përkritazi me ankesat me aktgjykimin PAKR.nr. 674/2023 datë 19 janar 2024, i ka refuzuar ato si të pabazuara dhe aktgjykimin e lartcekur e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve kanë paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë:

-mbrojtësit e të dënuarit Iran Badalli avokatët Emira Gavazaj e Valdrin Gashi (kërkesë të përbashkët), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe shkeljeve tjera të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen apo anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;

- mbrojtësit e të dënuarit Arben Gashi avokatët Hazer Susuri e Elinda susuri Humolli (kërkesë të përbashkët), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe shkeljeve tjera të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen në favor të dënuarit apo anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Prokurori i Shtetit me parashtrësën me shkrim KMLP.II.nr.227/2024 datë 24 qershor 2024, ka propozuar që kërkesat të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesat nuk janë të bazuara.

a) pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve përkritazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljet e ligjit penal

Mbrojtësit e të dënuarit Iran Badalli pretendojnë se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP, ngase dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është kundërthënës me arsyet e dhëna, përkatësisht faktet që i konsiderojnë të vërtetuara janë kundërthënëse me provat e administruara në shqyrtimet gjyqësore. Sipas mbrojtësve aktgjykimet e kundërshtuara janë voluminoze në faqe por aspak të qëndrueshme ligjërisht, sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar fajësia e të dënuarit Iran Badalli, sepse:

-në këtë çështje me akuzë janë përfshirë tre persona, duke përfshirë edhe të akuzuarin Valbon Çollaku i akuzuar për veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 364 par.1 të KPRK, mirëpo, gjykata e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë të arritur

në mes të prokurorisë dhe të akuzuarit Valbon Çollaku. Ndërsa, ky i akuzuar është inkuadruar më vonë si dëshmitar bashkëpunues duke sjell deklarata kundërthënës në mes veti, sepse tani më i njëjti kishte një aktgjykim fajësues, ndërsa, si dëshmitar bashkëpunues deklarata e tij është komplet në drejtim të fajësimit të dënuarit Iran Badalli, dhe kështu mbrojtjes i është pamundësuar mbrojtja adekuate dhe marrja në pyetje e të dënuarit Valbon meqenëse ai ishte dëshmitar bashkëpunues nga gjykata. Gjykata e shkallës së parë provat në të cilat e ka mbështetur aktgjykimin vetëm i ka parafrazuar dhe assesi nuk ka dhënë arsye se cila provë cilin fakt e ka arsyetuar, kurse, gjykata e shkallës së dytë vetëm i ka mbështetur arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, pa dhënë po ashtu asnjë arsye se kush e dërgoi mjetin shpërthyes-eksplozivin në shtëpinë e Iran Badallit. Nga të gjitha dëshmitë - deklaratat e dhëna në të gjitha shqyrtimet gjyqësore me asnjë dëshmitar dhe me asnjë provë materiale nuk është thënë mënyra se si Iran Badalli e ka marr eksplozivin se si e ka dërguar dhe si e paska vendosur në shtëpinë e tij konkretisht në shtratin e fëmijëve të tij të mitur, e po ashtu, nuk është vërtetuar me asnjë deklaratë në të gjitha dëshmitë e dhëna në shqyrtimet gjyqësore se i dënuari Iran ju ka thënë fëmijëve të mos shkojnë në katin e dytë, siç ka pretenduar gjykata, përkundrazi vet i dënuari Arben Gashi ka deklaruar se kur kishte shkuar tek shtëpia e Iranit pa prezencë të tij në kat të dytë fëmijët i ka paralajmëruar që të mos shkojnë në katin e dytë;

- në shkresa të lëndës gjendet edhe dëshmia e dëshmitarit Lëndim Berisha, i cili ka dhënë deklaratë në polici ku kishte sqaruar faktin se ishte takuar në qendrën e paraburgimit me të bashkëpunuesin tjetër Arben Gashi dhe sipas tij siç ia kishte sqaruar Arben Gashi e gjithë kjo ngjarje ishte montim kundër Iran Badallit për ta futur në burg dhe se Irani nuk kishte njohuri për këtë eksploziv dhe se asnjëherë nuk e kishte lënë në shtëpinë e tij, por, as gjykata e shkallës së parë dhe as ajo e shkallës së dytë nuk e përmendin këtë deklaratë si provë shfajësuese, edhe pse të dy gjykatat thirren në kuptim të nenit 360 të KPP-së i kanë shqyrtuar veç e veç të gjitha provat;

- provat kyçe në këtë çështje janë dy raportet dhe atë raporti informues me nr... datë 1.12.2022 i kryer nga Agjencioni i Kosovës për Forenzikë- Sektori për Daktiloskopi dhe ADN, si dhe raporti i ekspertimit i kryer nga po kjo agjenci me nr.referues ... datë 21.11.2022, të cilat me aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë shqyrtuara fare. Në të dy këto raporte mendimi përfundimtar është se “ nga dëshmia ... është fituar një profil AND-së i një personi të panjohur të gjinisë femërore dhe pika gjashtë nga dëshmia E/29 është fituar një profil i njëjti i ADN-së i një personi të dytë i panjohur i gjinisë femërore”, e përveç kësaj në këtë raport ekziston dhe shënimi “profile të ADN-së të fituara nga dëshmitë ..(thes i letrës së miellit dy shtresor me mbishkrimin “...” me të cilën kishte qenë mbështjell masa e dyshimtë shpërthyes dhe ... (tre shirita izolues me ngjyrë të verdhë) të cilat kanë rezultuar të jenë të gjinisë femërore janë me rëndësi të bëhet ekzaminimi- eliminimi nga personat që kanë pasur qasje në shtëpinë e të dyshuarve e të cilat mund të jenë bashkëshortet ose ndonjë familjar tjetër i gjinisë femërore. Sipas mbrojtësve nuk mund të kalojnë dy aktgjykime dënuese ndaj një të dënuari, ndërsa ekspertizat kyçe me vlerë provuese shfajësuese të mos merren fare për bazë nga një organ i drejtësisë. Kurse, arsyetimit i gjykatës së shkallës së dytë “ gjykata e apelit pati parasysh edhe pretendimet ankimore se në rastin konkret nuk janë marrë parasysh faktet dhe rrethanat se me asnjë prove nuk është vërtetuar se të akuzuarit e kanë vendosur mjetin shpërthyes në shtëpinë e Iran Badallit, duke aluduar se këtë e ka bërë personi i tretë, pastaj se në vendin e ngjarjes janë gjetur fije floku, të cilat sipas ekspertizës i takojnë gjinisë femërore, pra, që nuk i përkasin asnjërit nga të akuzuarit, pastaj se nga ekspertiza e daktiloskopisë është vërtetuar se në vendin

e ngjarjes dhe as në mjetin shpërthyes nuk janë gjetur gjurmë papilare të të akuzuarve, pretendime këto të cilat me të drejtë edhe gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar sit ë paqëndrueshme, të paargumentuara e që një vlerësim të tillë e ka edhe kjo gjykatë, ngase në bazë të provave të shkresave të lëndës është vërtetuar se të dy akuzuarit kanë shkuar tek dëshmitari V. Ç.,, prandaj nuk mund të aprovohen pretendimet se mjetin shpërthyes e ka sjellë dikush tjetër....”, arsyetim ky që lë për të nënkuptuar se gjykatat fajësinë e një personi e provojnë mbi bazën e jo arsyeshmerisë sepse në arsyetimin e tyre kanë theksuar se është e logjikshme se fijet e flokëve në vendin e ngjarjes kuptohet që mund t’i përkasin anëtareve të familjes, edhe pse këto ekspertiza ndërpresin lidhshmërinë e veprimit fillestar me vendosjen e eksplozivit në vendin ku ka shpërthyer dhe ka ndodhur ngjarja.

-nuk janë vërtetuar veprimet e secilit të dënuar veç e veç në drejtim të dërgimit të eksplozivit në katin e dytë të shtëpisë, në asnjë rrethanë nuk sqarohen veprimet e secilit edhe pse i dënuari Iran vazhdimisht ka thënë se nuk ka pas qëllim të blejë, por eksplozivi i është dashur të dënuarit Arben, dhe se ai as nuk e ka blerë dhe as nuk ka pasur njohuri se ku e ka vendosur atë i dënuari Arben nga momenti kur e ka pranuar nga V. Ç., ndërsa këtë fakt e ka potencuar edhe i dënuari Arben Gashi në seancën e kolegjit të shkallës së dytë duke theksuar se nga momenti kur e ka pranuar eksplozivin nga V., i dënuari Iran nuk ka pas të bëj me eksploziv.

-pretendimet e gjykatës së shkallës së parë se i dënuari Iran ka pas dijeni për eksplozivin që gjendet në shtëpinë e tij dhe se nuk i ka paralajmëruar zyrtaret policor nuk janë vërtetuar me asnjë deklaratë apo provë materiale, përkundrazi i dënuari i është përgjigjur menjëherë policisë ka vazhduar në fshatin Zh. është ndalur në shitore ka blerë bukë për fëmijët, ka shkuar në stacionin policor në fshatin Zh. (pasi që Arbeni e kishte lënë tek shitorja dhe ishte larguar) kur Iran Badalli nuk e ka gjetur Arben Gashi, jashtë në stacionin policor është paraqitur tek zyra e A. K. i cili zyrtar e kishte dërguar Iranin në shtëpi me veturë zyrtare të policisë, e kjo nënkupton se ai nuk ka pasur dijeni siç pretendojnë gjykatat ngase gjasat do të ishin me të mëdha që ai të largohej dhe të ikte e jo të paraqitej me zyrtar policor në shtëpinë e tij. Ky zyrtar është propozuar që të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit, por gjykata e ka refuzuar pa asnjë arsyetim ligjor, e kjo ka ndikuar që vendimi të mos jetë i drejtë dhe i ligjshëm.

-gjykata ka konkluduar se veprimet e zyrtareve policor kanë qenë të ligjshme, por sipas mbrojtësve veprimet e zyrtarëve policor në ditën e ngjarjes kanë qenë totalisht në keqpërdorim të autorizimit për kontroll, ngase kontrolli është filluar pa praninë e pronarit dhe pasi i akuzuari ju ka thënë se po niset për shtëpi, e në mungesë të dy dëshmitareve.

-pastaj, konkludimet e gjykatave përkitazi me raportin analitik -hartografinë e hyrje daljeve telefonike, hartografia e marr nga ... i veturës “T. Y., videoincizimet e kamerave (CD) ku shihen lëvizjet e automjetit në fshatin Zh. janë interpretuar në mënyrë të gabuar. Kjo provë kanë kërkuar që të plotësohet sepse ka qenë e përgjysmuar, sepse hartografia dhe ... nuk e vërteton faktin se me këtë makinë e ka dërguar në shtëpi Arben Gashi (sepse ajo tregon lëvizjet e makinës por jo edhe kush ka qenë prezent brenda makinës dhe këtë gjykata nuk e ka marr parasysh), sepse hartografia tregon lëvizjet e makinës-hyrje-ndalje, por jo edhe kush ka qenë brenda në makinë

- mbrojtësit pretendojnë po ashtu se nuk është vërtetuar se i dënuari e ka kryer edhe veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK përkitazi me eksplozivin e mbetur ... në peshë prej 809.1 gram dhe në detonator

mekanik në të cilin ishte vendosur një fitil ngadalë ndezës me gjatësi 63 cm. Sipas mbrojtësve i dënuari përpos që eksplozivin e parë nuk e ka dërguar në shtëpinë e tij, as eksplozivin e dytë ... nuk e ka blerë, kurse, dëshmitari V. Ç. ka deklaruar se fitili i donatorit që ua ka shitur ka qenë me i shkurtër.

Sipas mbrojtjes si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale është shkelur edhe ligji penal, ngase po të merreshin për bazë shumë prova dhe fakte i dënuari do të lirohej nga akuza.

Kurse, mbrojtësit e të dënuarit Arben Gashi me kërkesa pretendojnë se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.2 nënpar.2.1 e 2. 7 të KPRK. Aktgjykimet e kundërshtuara janë të paqarta, ngase ekziston kontradiktë e theksuar midis asaj çfarë paraqitet ne arsyet e aktgjyqimit lidhur me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve për deklarimet e dhëna në procedurë nga ana e të dënuarve dhe dëshmitarëve. Kështu, gjykatat kanë konkluduar se të dënuarit janë pikërisht personat që e kanë sjellë dhe vendos mjetin shpërthyes eksplozivin në shtëpinë e të dënuarit Iran Badalli, mirëpo, ky konkludim nuk provohet me provat e administruara. Dëshmitarët A. M., J. H., A. B. e R. B. nuk e vërtetojnë faktin dhe as që e dinë se kush e ka vendosur eksplozivin në shtëpinë e të dënuarit. Me pas mbrojtësit citojnë deklaratën e dëshmitarit V. Ç. duke pretenduar se kjo dëshmi nuk vërteton faktin se eksplozivi është blerë nga i mbrojturi i tyre. Sipas mbrojtësve i dënuari Arben nuk e ka blerë eksplozivin me ndezje të dirigjuar nga larg e as me fitil dhe eksplozivin me tetrapak ditën e blerjes e ka mbajtur në veturën e tij e nuk e ka dërguar në shtëpi të dënuarit Iran, e që rrjedh konkludimi se eksplozivin në shtëpinë e Iran Badallit nuk e ka vendosur Arben Gashi e as Iran Badalli, siç theksohet me aktgjykimet e kundërshtuara, madje kjo vërtetohet edhe nga deklaratat e të dënuarit Arben Gashi i cili në seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë ka sqaruar se nuk e ka kryer këtë vepër, duke theksuar se i dënuari e ka siguruar eksplozivin lëndor por të njëjtin ia ka dorëzuar L. Sh. (ish bashkëshortes se të dënuarit Iran) e çfarë ka bërë ajo me atë nuk e din dhe se i dënuari Iran nuk ka të bëjë me sigurimin dhe vendosjen e eksplozivit në shtëpinë e tij. Eksplozivi i formës së boksit të gjelbër nuk ka qenë eksplozivi i blerë nga i dënuari Arben Gashi dhe as Iran Badalli, por eksploziv të cilin as ekspertiza përkatëse nuk e ka definua se çfarë lloji ishte ai, dhe si është aktivizuar nga distanca apo me fitil apo me prekje. Përndryshe si mund të shpjegohet se në shtratin e gjumit të fëmijëve krevatin e tyre është gjetur eksplozivi ... me një fitil dhe i njëjti nuk ka eksplodua, dhe si mund të shpjegohet fakti se në këtë eksploziv të pa eksploduar është gjetur fije e flokut që i përket flokut të femrës e jo të mashkullit, e që jep me kuptuar se të dënuarit nuk e kanë dërguar eksplozivin në dhomën e gjumit, dhe këtë e vërteton edhe ekspertiza e daktiloskopisë ngase nuk ka gjurmë të gishtërinjve as të dënuarit Arben dhe as të dënuarit Iran, ndërsa konkludimet e gjykatave përkitazi me këto prova janë të paqëndrueshme. Mungesa e arsyeve të dhëna përkitazi me këto prova paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, e që për pasojë tërheq anulimin e aktgjyqimeve pa u lëshuar në pretendimet tjera.

-pretendimet e mbrojtësve të të dënuarit Arben Gashi përkitazi me shkeljet e ligjit penal konsistojnë në atë se në rastin konkret është shkelur ligji penal ngase me asnjë provë nuk janë vërtetuar veprimet inkriminuese të të dënuarit Arben Gashi dhe nuk është plotësuar elementi objektiv dhe subjektiv i veprave penale për të cilat është shpall fajtor. Me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas mbrojtësve është bërë shkelja e ligjit penal, ngase po të

vlerësoheshin me kujdes të gjitha provat do të merrej aktgjykim tjerët, pra do vihej deri të përfundimi se i dënuari nuk është kryes i veprave penale për të cilat është akuzuar.

b) Vlerësimi i kësaj gjykate përkitazi me pretendimet e mbrojtëseve në kërkesa

Vlen të theksohet se mbrojtësit e të dënuarve i kundërshtojnë aktgjykimet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP, por, nuk japin arsye se në çka konsistojnë këto shkelje përveç parafrazimit të dispozitës ligjore se “gjykatat nuk kanë dhënë arsye të qarta përkitazi me faktet vendimtare, kurse arsyet e dhëna janë në kundërshtim me shkresat e lëndës”, kurse, nën petkun e kësaj baze ligjore e kundërshtojnë gjendjen faktike (për të cilën bazë ligjore kërkesa nuk mund të paraqitet- neni 432 par.2 i KPP), ngase kontestohen dëshmitë e dëshmitarëve, provat materiale dhe konkludimet e gjykatave në bazë të këtyre provave. Në të vërtetë pretendimet e mbrojtësve të të dënuarit Arben Gashi përkitazi me të dy bazat ligjore qoftë për shkelje esenciale apo të ligjit penal janë të njëjta me pretendim se nuk është provuar se i dënuari e ka kryer veprën, ngase faktin se i dënuari Arben nuk e ka kryer veprën penal e vërteton deklarata e tij në seancë të kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë në të cilën ka theksuar se *“eksplozivin e siguruar nga V. Ç. me kërkesën e bashkëshortes së të dënuarit Iran ia ka dorëzuar asaj dhe se çka bërë ajo nuk e din”*

Megjithatë, përkundër faktit se për bazën ligjore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet, meqë gjendja e fakteve e determinon edhe aplikimin e ligjit penal, dhe meqë kemi të bëjmë me një çështje ku ka humbur jetën një zyrtar policor, tre tjerë janë lënduar rëndë, dhe lëndime të rënda trupor ka pësuar edhe fëmija i të dënuarit Iran, kjo gjykatë vlerëson se është në interes të drejtësisë, të dënuarve, e në veçanti të palëve të dëmtuara të shqyrtoj pretendimet në këtë drejtim. Kurse, pas shqyrtimit të pretendimeve në kërkesa në raport me aktgjykimet e kundërshtuara dhe shkresat e lëndës kjo gjykatë gjen se ato janë të pabazuara, për këto arsye:

Se pari, aktgjykimi i shkallës së parë i cili është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në kërkesa. Gjykatat në pajtim me dispozitën e nenit 369 par.6 e 7 të KPP kanë paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimet, kanë vlerësuar provat e administruara si ato materiale dhe jo materiale, dëshmitë e dëshmitarëve dhe mbrojtjen e të dënuarve, dhe kanë dhënë arsye të qarta se cilës provë apo dëshmi ia kanë falur besimin dhe pse, të cilat arsye si të drejta i ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së dytë dhe si tilla i vlerëson edhe kjo gjykatë, dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë vlerësime edhe njëherë në këtë drejtim.

Se dyti, në kontekst të vlerësimit të provave të administruara në këtë çështje juridiko penale kjo gjykatë i vlerësoj pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve se nuk është vërtetuar se të dënuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe shpall fajtor dhe gjeti se ato janë të pabazuara.

Në këtë çështje është evidente se në aktakuzë ka qenë i përfshirë edhe dëshmitari bashkëpunues V. Ç., i akuzuar dhe dënuar për veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 364 par.1 të KPRK (i cili ka pranuar fajësinë, dhe procedura ndaj tij është veçuar), i cili është dëshmitari kyç i kësaj çështje nga dëshmia e të cilit rezulton pa mëdyshje se

eksplozivin i cili ishte objekt i akuzës nga shpërthimi i të cilit ka humbur jetën zyrtari policor S. Th., tre tjerë janë lënduar rëndë, dhe është lënduar rëndë edhe fëmija i të dënuarit Iran, ua kishte shitur të dënuarve Arben Gashi e Iran Bidalli. Dëshmia e tij jo vetëm që nuk është kundërthënëse, por është reale dhe konsistente për çka edhe është shpallur dëshmitar bashkëpunuese, dëshmi e cila përputhet edhe me dëshminë e dëshmitarit R. B., dhe pjesërisht edhe me mbrojtjen e të dënuarve të cilët në mbrojtjet e tyre edhe pse janë mjaft kundërthënës (duke ia hedhur përgjegjësinë njeri tjetrit) nuk e mohojnë faktin se eksplozivin e kanë marrë nga ky dëshmitar, kurse, duke pasur parasysh faktin se ky dëshmitar nuk kishte pengesa ligjore që të dëgjohej në shqyrtimin gjyqësor (neni 13 par.1 nënpar.1.3 i KPP), është dëgjuar, kurse, mbrojtësit kanë pasur mundësinë ta kundërshtojnë dëshminë e tij, për këtë gjykatë nuk është e qartë se si mbrojtësve ju është pamundësuar mbrojtja adekuate dhe marrja në pyetje e të dënuarit Valbon meqë ai ishte dëshmitar bashkëpunues.

Qëndron fakti se në shkresa të lëndës gjendet edhe dëshmia e dëshmitarit Lëndim Berisha, i cili ka dhënë deklaratë në polici, sipas të cilit ai ishte takuar në qendrën e paraburgimit me të bashkëpandehurin Arben Gashi dhe sipas tij siç ia kishte sqaruar Arben Gashi e gjithë kjo ngjarje ishte montim kundër Iran Badallit për ta futur në burg dhe se Irani nuk kishte njohuri për këtë eksploziv dhe se asnjëherë nuk e kishte lënë në shtëpinë e tij, por, ia përkujtojmë mbrojtjes se ky dëshmitar nuk është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, e meqë nuk është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor gjykatat nuk kanë mundur ta theksojnë dëshminë e tij, ngase gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, dhe duke pasur parasysh se ky dëshmitar dëshmon për atë çka i kishte thënë i dënuari Arben Gashi deklarata e tij edhe pse është provë shfajësuese, duke pas parasysh se ky dëshmitar ka deklaruar përkitazi me të thënat e një personi që është akuzuar dhe gjykuar, nuk do ta ndryshonte gjendjen e fakteve në raport me provat fajësuese.

Pastaj, dëshmitari i dëmtuar A. M. – në dëshminë e tij ka deklaruar se “si hetues i njësisë së antidrogës ditën e ngjarjes derisa ishte në detyrë se bashku me kolegen e tij J. H. rreth orës 19-19 :30 kishte pranuar një thirrje nga qendra e thirrjeve “G. K.”- në P., dhe ishte njoftuar nga zyrtari përgjegjës se kishte pranuar një thirrje telefonike nga një vajzë e cila kishte raportuar se në shtëpi e kishte pa të pandehurin Iran Badalli duke fshehtë lëndë narkotike. E kishte njoftuar mbikëqyrësin e tij rreshter A. B. dhe pastaj kishte marrë informatën nga mbikëqyrësi se kishin leje dhe pëlqim nga gjyqtari i procedurës paraprake për kontroll të shtëpisë së Iran Badallit, dhe menjëherë kishin filluar përgatitjet për zbatimin e kontrollit. Posa kishin arritur pjesëtarët e reagimit të shpejtë – njësia speciale ishin nisur në drejtim të fshatit Zh., ku fillimisht kishin shkuar tek nënstacioni policor në Zh. pastaj kishin shkuar tek shtëpia e të dënuarit. Njësia speciale ishin marrë me perimetrin e jashtëm, kurse, se bashku me kolegun S. Th. (i ndjeri) kishin hyrë brenda dhe e kanë kërkuar të dënuarin. Kishin vërejtur dy fëmijët e tij të cilin ishin duke u pastruar të cilëve ju kishin ndihmuar që të visheshin. Vajza e të dënuarit ju kishte treguar se i kishte thirrur dhe ju kishte thënë që të mos i tregonin babit të tyre sepse do e rrahtë apo e mbyste. Në atë moment vajzën e kishte telefonuar i dënuari dhe me lejen e mbikëqyrësit kishte folur me të dhe kishte kërkuar nga ai që të paraqitej në vendin e ngjarjes. Pastaj, se bashku kanë shkuar në katin e dytë pasi që vajza ju kishte thënë se e kishte pa babanë e saj duke mbështjell diçka në rroba dhe në jastëk, e që dyshohej se ishte lëndë narkotike. Derisa ishte në pritje të dëshmitareve për të filluar kontrollin kishte biseduar me vajzën e cila i kishte thënë se nëna e saj gjendej tek familja e saj se babai i saj kishte filluar të shiste të gjitha orenditë e shtëpisë dhe do ta shiste edhe derën e shtëpisë. Pasi që kishin shkuar në dhomë ku dyshohej për narkotikë

ishte i ulur në gjunjë, ndërsa kolegu i tij i ndjerë i cili ishte afër tij i kishte thënë babush këqyr çka gjeta, në momentin kur është kthyer dhe i ka thënë çka ka ndjerë një dritë të madhe dhe një nxehtësi të jashtëzakonshme dhe zhurmë, është përplasur në dysheme dhe fillimisht i ka lëvizur këmbët e pastaj duart dhe e kishte thirre kolegun e tij”. Në mënyrë të njëjtë kanë deklaruar edhe dëshmitarët -të dëmtuarit zyrtarët policor J. H. e A. B.. Kurse, nga prova materiale-leximi i radiologut të Stacionit policor – Njësia “G. K.”, datë 2.01.2020, nga ora 8:00 e deri në ora 20:00, rezultojnë komunikimet që janë bërë nga zyrtaret policor, e edhe informata me numër ... në ora 18:10 minuta, sipas, numrit të telefonit ..., nga e cila është informuar policia e Kosovës se prindi I. B. nga fshati Zh. mban shumë narkotikë në shtëpi të cilën ua shet personave të ndryshëm të cilët e mban në WC dhe në katin e dytë.

Duke pasur dëshmitë e këtyre dëshmitarëve dhe provën materiale- leximi i radiologit të stacionit policor - kjo gjykatë vlerëson se veprimet e policisë janë ndërmarrë konform dispozitave ligjore (nenit 108 të KPP) në fakt policia i është përgjigjur një thirrje të një fëmije e cila po e denonconte prindin e tij për narkotikë, kurse pretendimet e mbrojtjes se veprimet e policisë ditën e ngjarjes kanë qenë totalisht në keqpërdorim të autorizimit për kontroll janë krenjtësisht të pabazuara.

Ndërsa, është evidente se hartografia e lëvizjes se veturës “T. Y.” të cilën i dënuari Arben Gashi e kishte marrë me qira ditën e ngjarjes, hartografia dhe ... i veturës nuk e vërteton faktin se me këtë veturë të dënuarin Iran e kishte dërguar në shtëpi Arben Gashi, sepse hartografia tregon lëvizjet e makinës-hyrje-ndalje, por jo edhe kush ka qenë brenda në makinë, mirëpo, sipas kësaj hartografie del se i dënuari Arben rreth orës 18:00 ka filluar lëvizjen nga P. në drejtim të P., nga lëvizjet e ... del se i dënuari Arben Gashi fillimisht ka lëvizur nga Zh. tek lokali qebaptore “T.B.” që gjendet në dalje të autostradës në veri dhe aty ka mbërrirë rreth orës 19: 14 :52min., me të cilin ka qenë edhe Iran Badalli dhe kanë qëndruar deri në ora 19 : 47 :24 dhe se në këtë kohë janë larguar nga lokali për shkak se Iranin e kishte thirre policia dhe kanë vazhduar për në Zh., ku sipas hartografisë kanë kaluar rrugës nga shkolla në Zhur duke vazhduar rrugën që shpije tek shtëpia e Iran Badallit në një rrugicë nga ana e epërme e shtëpisë së Iranit dhe dikur rreth orës 19: 58:51min., Arben Gashi është ndalur tek posta në Zh. dhe aty është parkuar për dy minuta, me pas Iran Badalli ka tentuar qe edhe dy herë ta thërras Arben Gashin mirëpo telefoni i tij ka qenë i shkyçur dhe përfundimisht i dënuari Arben Gashi ka vazhduar me veturën e tij në një lokal e më pas është larguar për në Sh.,. Këto fakte vërtetohen edhe raporti ligjor i lëshuar nga ...-... datë 3.02.2020. Këto fakte nuk i kanë mohuar as të dënuarit në mbrojtjet e tyre. Kështu, i dënuari Arben në mbrojtjen e tij të dhënë në prokurori nder të tjera ka theksuar se *“rreth orës 18:00, e kishte marrë një automjet me qira të markës “T.” dhe është nisur në drejtim të P., gjatë rrugës e ka telefonuar Irani dhe i kishte thënë ta merrte në hyrje të fshatit, pastaj kanë shkuar për kafe tek rruga transitore saktësisht tek restoranti B. ku kanë qëndruar rreth 20 minuta, pasi që ka shkuar në tualet, kur është kthyer Irani bisedonte ne telefon me policinë për shkak të dhunës në familje, pastaj e kishte dërguar Iranin para xhamisë së fshatit, ai është ndalur për të marrë diçka në shitore, kur kishte dal nga shitorja e kishte telefonuar të motrën, pastaj e kishte dërguar përmbi shtëpi të tij, ai kishte dal nga makina, pastaj kishte lëvizur nëpër fshat, e pastaj kishte dal në rrugën V.- P., dhe kur kishte arritur tek gurthyesi “V. e b.” kishte dëgjuar një krismë të vogël dhe kishte dyshuar se diçka kishte ndodh tek shtëpia e Iranit, për çka kishte pas dilema a të shkonte për Sh. apo në fshatin B., por ishte nisur për Sh.”.* Ndërsa, faktin se të dënuarit ditën kritike para ngjarjes janë takuar diku rreth orës 19-19 e 30

min., dhe kanë qenë se bashku nuk e ka mohuar as i dënuari Iran Badalli, prandaj për këtë gjykatë nuk është e qartë se në çka konsistojnë pretendimet e mbrojtësve në këtë drejtim.

Pra, bazuar në provat e administruara si dëshmia e të dëshmitarit V. Q. dhe R. B. del qartë se të dënuarit sipas marrëveshjes paraprake e kishin blerë eksplozivin nga dëshmitari V., të cilin se bashku e kishin marr nga ky dëshmitar (a pagesën për eksploziv e kishte bërë i dënuari Arben). Po ashtu, nuk rezulton kontestues fakti se ditën e ngjarjes para momentit kritik zyrtarët policor i janë përgjigjur thirrjes së vajzës e të dënuarit Iran, se të dënuarit ishin bashkë para momentit kritik derisa i dënuari Iran ishte ftuar nga policia që të shkonte në shtëpi që të jetë prezent gjatë bastisjes se shtëpisë, dhe i dënuari Iran kishte shkuar në shtëpi pas shpërthimit të eksplozivit, kurse, i dënuari Arben ishte larguar dhe shkuar në Sh..

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes, pas analizimit dhe vlerësimit logjik dhe të tërësishëm të provave në këtë çështje, e në veçanti mbrojtjes se të dënuarve të dhënë në të gjitha fazat e procedurës, faktin se të dënuarit ishin shokë dhe njiheshin që 13 vite, kurse shkonin familjarisht tek njeri tjetri, i vetmi përfundim logjik edhe për këtë gjykatë është se të dënuarit përpos që sipas marrëveshjes paraprake e kishin blerë eksplozivin nga V. Q., edhe e vendosin në një dhomë në katin e dytë të shtëpisë së të dënuarit Iran, kurse janë të pabazuara pretendimet se nuk është argumentuar se të dënuarit e kanë vendosur eksplozivin në shtëpinë e të dënuarit Iran, ndërsa, të paqëndrueshme dhe skajshmerisht të papranueshme janë pretendimet se i dënuari Arben Gashi në seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë ka sqaruar se nuk e ka kryer këtë vepër duke theksuar se “i dënuari e ka siguruar eksplozivin lëndor, por të njëjtin ia ka dorëzuar L. Sh. (ish bashkëshortes se të dënuarit Iran)”. Në fakt nga mbrojtja e të dënuarit Arben Gashi në të gjitha fazat e procedurës del qartë se mbrojtja e tij është në drejtim të minimizimit të rolit të dënuarit Iran në këtë çështje, gjë që vërtetohet edhe nga mbrojtja e të dënuarit Iran (i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar se të dënuarit Iran i duhej eksplozivi) dhe dëshmia e të dëmtuarit R. B. i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se motra e të dënuarit Iran i ka bërë presion dhe e ka shqetësuar duke e thirrur në telefon duke i kërkuar që ta ndryshoj deklaratën për ta shpëtuar Iranin, përderisa në shkallë të dytë pretendohet se eksplozivin e kishte marrë ish bashkëshortja e të dënuarit Iran.

Përkritazi me provat - dy raportet dhe atë raporti informues me nr... datë 1.12.2022 i kryer nga Agjencioni i Kosovës për Forenzikë- Sektori për Daktiloskopi dhe ADN, si dhe raporti i ekspertimit i kryer nga po kjo agjenci me nr.referues ... datë 21.11.2022, se në vendin e ngjarjes janë gjetur fije floku, të cilat sipas ekspertizës i takojnë gjinisë femërore, pra, që nuk i përkasin asnjërit nga të dënuarit dhe nga ekspertiza e daktiloskopisë është vërtetuar se në vendin e ngjarjes dhe as në mjedin shpërthyes nuk janë gjetur gjurmë papilare të të akuzuarve, kanë dhënë arsye të qarta dhe logjike gjykatat e instancave me të ultë, të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë duke pasur parasysh ecurinë e ngjarjes dhe provat tjera në këtë çështje.

Në fakt pretendimet në kërkesa nuk e venë në dyshim saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara me aktgjykimet kundër të cilave është paraqitë kërkesa, pra, në rastin konkret bazuar në gjendjen e fakteve drejt është aplikuar edhe ligji penal, pra, kjo gjykatë e mbështet konkludimin e gjykatave se në veprimet e të dënuarve qëndrojnë elementet e veprave penale për të cilat janë shpall fajtor dhe gjykuar.

Nga arsyet e lartcekura kjo Gjykatë kërkesat e mbrojtësve i refuzoj si të pabazuara, kurse konform dispozitës së nenit 437 të KPP vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
PML.nr.395/2024 datë 23 dhjetor 2024

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi